



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:116233

Datë: 28.01.2022

Numri i dokumentit: 02655064

C.nr.99/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Blerim Beshtica, me zyrtarën ligjore Bionda Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditësit A.... E... nga fshati Zh...., komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. E...Q... nga Gjilani, kundër të paditurve M... K..., D.. K... dhe M... K... të gjithë nga fshati L.. i U, komuna e Gj, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 1.000,00 euro, jashtë seances me datë 28.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndërprehet procedura në këtë çështje kontestimore për shkak të vdekjes së paditësit A... E nga fsh. Zh..., komuna e Gjilanit.

Procedura e ndërprerë do të vazhdoj kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë, apo me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësja, ka parashtruar padi kundër të paditurve, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 1.000,00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë ka vendosur meritorisht sipas aktgjykimit të saj C.nr.839/14 të datës 04.03.2016, mirëpo për shkak të ankesës së parashtruar nga të paditurit ndaj këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur sipas kësaj ankese, me aktvendimin e saje ka prishur aktgjykimin e ankimuar C.nr. 839/2016 të datës 04.03.2016 dhe lënda ia ka khyer në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurë të rigjykimit dhe rivendosjes gjykata me datë 11.01.2022 e ka caktuar seancën përgaditore, në të cilën seancë nuk ka prezantuar pala paditëse por i autorizuari i tij av. Elmi Qerimi e ka njoftuar gjykatën se paditësi ka vdekur dhe i ka propozuar gjykatës që të ndërpritet procedura, kurse në këtë seancë ka prezantuar vetëm i padituri i tretë Murselim Rashiti, i cili po ashtu e ka njoftuar ka shtuar se paditësi ka vdekur para 7-8 muajve.

Si rrjedhojë, gjykata ka kërkuar informacione në rrugë zyrtare nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, për të verifikuar faktin e vdekjes së të padituri, gjë që Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, si dëshmi gjykatës i ka dorëzuar C.... e V..... me nr. serik....., nr.të referencëssipas të cilës certifikatë konstatohet se paditësi në fjalë ka vdekur më datë 01.07.2019.

Sipas nenit 277, paragrafi 1, pika a) të LPK-së është paraparë se në rastet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësin procedurale, procesi gjyqësor ndërpritet, ndërsa me nenin 280.1 të po këtij ligji është paraparë se procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277, paragrafi 1, pika a) dhe d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Duke pas parasysh faktin se paditesi Ahmet Emini ka vdekur, gjykata konform dispozitave të cekura më lartë, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.99/2020, me datë 28.01.2022

Gjyqtari,
Blerim BESHTICA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kesaj gjykate.